



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit, mbajtur më 02.10.2020, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Adrian Berisha (PSD), Bashkim Beha (PSD), Visare Gashi (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Nazlie Bala (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Naim Hoxha (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Valbona Petrovci (e pavarur), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (Grupi i pavarur) dhe Granit Shala (Nisma).

Munguan: Hafiz Krasniqi (LDK), Naime Osmani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur) dhe Migjen Shala (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Shpresa Shala, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Fitim Rexha, drejtor i Drejtorisë së Sportit, Shkumbin Gashi, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit. Para se të fillonin me diskutimet për rendin e ditës, kryesuesi bëri të ditur se është takuar me shefat e grupeve parlamentare për të diskutuar rreth mbarëvajtjes së punës së Kuvendit, ku të gjithë ishin dakord se në raste të shpeshta po ka edhe tejkalim të rregullores. Tash e tutje do t'i përmbahemi Rregullores së punës së Kuvendit dhe

Faqe 1 nga 4

komiteteve, që mbledhjet të mbahen në mënyrë sa më racionale dhe të jenë sa më produktive.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës dhe konstatoi se prezent në sallë ishin 35 anëtarë të Kuvendit.

Më 21 vota për dhe 14 kundër, u miratua ky

Rend i ditës:

- 1. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2021- 2023;**
- 2. Propozimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale në kategoritë “Subvencione dhe transfere” dhe “Mallra dhe shërbime”.**

Pika e parë

Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2021- 2023.

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2021- 2023, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Valbona Makolli, drejtoreshë, duke thënë se bazuar në Qarkoren e tretë, buxheti për vitin 2021 është në shumën 85 milionë e 7992 mijë e 837 euro, të ndara në pesë kategori, “paga dhe mëditje”, “mallra dhe shërbime”, “komunali”, “subvencione” dhe “kapitale”. Të gjitha këto kategori janë ndarë nëpër drejtori të caktuara, sipas projekteve.

Halim Halimi u shpreh se nuk ka pasur nevojë të thirret mbledhje e jashtëzakonshme për pikat më të rëndësishme të rendit të ditës për Kuvend, e që është buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2021, por do të duhej të thirrej mbledhje e rregullt, t’iu dërgohet anëtarëve të Kuvendit materiali me kohë, që të kenë kohë ta analizojnë dhe të japin kontribut në mbledhje. Kisha kërkuar që të hiqet kjo praktikë e keqe, se hartimi i buxhetit për vitin 2021 kërkon punë. Jemi dëshmitarë të asaj që shumë projekte vazhdimisht parashihen në buxhet, mirëpo nuk po realizohen. Ne i kemi propozimet tona, nëse këto propozime hyjnë në buxhet ne do ta votojmë, nëse nuk merren parasysh, atëherë nuk do ta votojmë.

Valbona Makolli, drejtoreshë, tha se ne kemi pasur dëgjime buxhetore, një ditë të plotë e ka pasur Kuvendi komunal, në formën online, për paraqitjen e kërkesave të qytetarëve, por askush nuk është lajmëruar. Po ashtu, të shtunën i kam ftuar të gjithë shefat e grupeve parlamentare, kush ka pasur mundësi me ardhur, dhe të gjitha kërkesat janë marrë parasysh, kështu që sa i përket njoftimit, të gjithë janë njoftuar.

Genc Sherifi tha se ne do ta përkrahim këtë propozimbuxhet të vitit 2021.

Mirsad Vitia u shpreh i pajtimit me diskutimin e përfaqësuesit të GP të LDK-së, andaj dhe e përkrahu një propozim të tillë.

Ai tha se ky buxhet nuk është gjithëpërfshirës, kur e dimë se kemi lagje në komunën tonë ku nuk ka as shkollë, as çerdhe, as Bashkësi lokale etj. Shihet se në vitin 2021 do të kemi ulje të granteve dhe burimeve vetanake dhe do të kemi rënie të buxhetit. Nëse i shikojmë drejtoritë veç e veç, shohim se pothuajse në të gjitha drejtoritë do të kemi rënie të buxhetit. Po ashtu, në subvencione dhe transfere do të kemi ulje në disa drejtori. Lidhur me ftesën për pjesëmarrje në takimin e së shtunës me drejtoreshën e Drejtorisë së Financave, tha se ne si Grup parlamentar nuk kemi qenë të ftuar në këtë takim, andaj këtë e ngriti si vërejtje.

Leutrim Retkoceri tha se sa i përket këtij propozimbuxheti, ne si Grup parlamentar kërkojmë nga Komuna e Prishtinës, që të mos e nxjerrë sot në votim buxhetin e vitit 2021. Propozimbuxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2021, për shumë arsye nuk i plotëson nevojat e qytetarëve të Prishtinës, nuk ka të mjaftueshëm as kontribut të qytetarëve përmes dëgjimeve publike, por as kontribut të të gjitha partive politike që janë pjesë e Kuvendit komunal, të cilat mund ta pasurojnë edhe më shumë përmbajtjen e tij. Ky propozimbuxhet u është dërguar shumë vonë asamblistëve dhe grupeve të partive politike pjesëmarrëse në Kuvendin komunal. Çfarë arsye dhe çfarë mundësie kemi ne si asamblistë të trajtojmë materialet, kur ato vijnë natën, një apo dy ditë para mbajtjes së seancës. Kërkojmë që Komuna e Prishtinës ta shtyjë për disa ditë votimin e buxhetit, që të planifikohet edhe më mirë ky buxhet, i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm për qytetarët e komunës së Prishtinës.

Sami Boroci tha se po ta krahasojmë këtë buxhet me buxhetin e vitit paraprak, vërejmë se buxheti i vitit 2021 është më i ulët sesa ai i vitit 2020, mirëpo këtu duhet të kemi parasysh që një ndikim të madh e ka ecuria, ose pandemia e shfaqur në këtë vit dhe afektimin që do të ketë vitin tjetër.

Nëse ndalemi nëpër drejtori, prioritet më të madh do duhej t'i jepej Drejtorisë së Bujqësisë në subvencionime, sepse ka resurse goxha të mëdha dhe Prishtina, besoj që ka një sipërfaqe me territor të madh qoftë në zonën e Gollakut, qoftë në zona tjera, ku do të duhej të përkrahen këta bujq, në mënyrë që me stimuluar edhe jetesën në këto pjesë. Kështu që buxheti i planifikuar për Drejtorinë e Bujqësisë po vazhdon me qenë shumë i vogël, andaj besoj se kjo duhet të rritet. Po ashtu, Drejtoria e Sportit pak po trajtohet, andaj kërkoj që kjo fushë të trajtohet më seriozisht për përkrahjen e projekteve të ndryshme sportive.

Fiknete Bejta tha se ne si Grup i pavarur faktikisht nuk kemi pasur kohë që ta trajtojmë këtë buxhet dhe ta analizojmë, pasi që nuk ishim të informuar, nuk kemi qenë në grupin e shefave të grupeve, dhe mendoj se si grup jemi të anashkaluar gjatë hartimit të këtij projektbuxheti. Nuk mund të votojmë diçka për të cilën nuk jemi të informuar dhe për diçka që kërkesat tona si grup nuk kemi mundur t'i trajtojmë në këtë projektbuxhet. Andaj, kemi një mëdyshje që më mirë kjo pikë për projektbuxhetin të shtyhet për ndonjë seancë tjetër dhe të trajtohen edhe kërkesat e këshilltarëve të tjerë komunalë.

Egzon Azemi theksoi se kjo seancë nuk do të duhej të ishte mbledhje e jashtëzakonshme, por të ishte mbledhje e rregullt, sepse është seanca më e rëndësishme e vitit. Në këtë mbledhje është dashur të jetë prezent edhe kryetari, Shpend Ahmeti, dhe drejtori, Genc Bashota, sepse është çështje buxheti dhe punët e tyre janë të lidhura direkt me buxhet. Ky është një ofendim që po u bëhet të gjithë asamblistëve dhe kushdo që e voton këtë buxhet në këtë sallë, është një vegël e kësaj qeverisje të hajnisë.

Agim Gashi tha se me qenë se ne i dëgjuam përfaqësuesit, shefat e grupeve, për kërkesat që i patën, propozoj që të merren parasysh kërkesat dhe sugjerimet që i dhanë, dhe si zgjidhje e mundshme është që të bëhet një pauzë, të ftohen shefat e GP-ve dhe të shihen mundësitë e inkorporimit të kërkesave të tyre. Njëherësh propozoi që për Drejtorinë e Bujqësisë të shtohen 300 mijë euro subvencione, sepse kjo do të ndihmonte që drejtoria të luajë rolin e vetë karshi përkrahjes në fushën e bujqësisë.

Kryesuesi konstatoi se prezentë në sallë ishin 34 anëtarë të Kuvendit. Më 26 vota për dhe 5 abstenime, u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021 dhe Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2021- 2023.

Pika e dytë

Propzimvendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale në kategoritë "Subvencione dhe tranfere" dhe "Mallra dhe shërbime".

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë ishin 36 anëtarë të Kuvendit.

Më 30 vota për dhe 6 abstenime, u miratua Vendimi për transferimin e mjeteve nga fondi i rezervës komunale në kategoritë "Subvencione dhe tranfere" dhe "Mallra dhe shërbime".

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta**

